



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 115, datë 25.07.2025

**PËR
MIRATIMIN E RIEMËRIMIT NË POZICIONIN E KRYETARIT DHE ANËTARIT TË
KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË “SIGAL UNIQA INVEST -
SHOQËRIA ADMINISTRUESE E FONDEVE TË PENSIONIT PRIVAT DHE
SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE” SH.A.**

Në zbatim të pikës 22, të nenit 14, të ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”, ligjit nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, rregullores nr. 112, datë 31.08.2020 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, si dhe rregullores nr. 1, datë 31.01.2024, “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat dhe depozitarit të fondeve të pensionit privat të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e riemërimit të z. Adrian Totokoçi në pozicionin e Kryetarit të Këshillit të Administrimit, z. Abdyl Sarja, z. Edvin Hoxhaj dhe z. Klement Mersini, në pozicionin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit të shoqërisë “Sigal Uniqa Invest - shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive” sh.a., deri në datë 19.04.2028.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Saimir TOLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Mimoza KAÇI